

VENDIM
Nr. 200, datë 4.3.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, TË OBJEKTIT ME EMËRTIMIN “ISH-DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT, KORÇË”, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 906, DATË 19.12.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pasuritë e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të objektit me emërtimin “Ish-Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë”, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për t'u përdorur për mjedise pune, për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të veprimtarisë administrative të këtij institucioni.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Arkivi Shtetëror Vendor, Korçë, nuk mund t'a ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t'a tjetërsojë atë apo t'u japin në përdorim të tretëve.

3. Prona, e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të miratuar me vendimin nr. 906, datë 19.12.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe t'i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të miratuara me vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUEJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Shërbimi Kombëtar i Punësimit				Identifikoi: Ilir KARANXHA, Specialist për Investimet (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Supervizori: Brikena NALLBANI, Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Aprovoi: Genci KOJDHELI, Drejtor i Përgjithshëm (Tel:35544538800) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, rubra)						
Bashkia: Korçë				Fusha e përdorimit të pronës: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dhe Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Korçë						
Nr rend	Zona Kadastrale dhe Indeksi i Hartes	A		Emri i Pronës Adresa	B		C			Te dhena të tjera (shënime të veçanta)
		Nr Pasurisë	Lloji i Pronës		Sipërfaqja Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale sa Ndertese (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Administrative	Zyre Rajonale e Punësimit Korçë Lagja nr.9 Rruga "1 Maji" Korçë	467.9	400	Zyre Rajonale Punësimi	M.P.Ç.S.SH.B	SH.K.P/ ZRP Korçë (ne pronësi)	Ambientet ndodhen në një ndertese 3 kateshe ne pronesi te MPÇS e rikonstruktuar me fondet e B.Boterore per Zyre Punësimi. Z.R.P e zhvillon aktivitetin në katin e dyte dhe GFP ne katin e trete te nderteses.Katin e pare te saj e ka ne përdorim Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore.

